Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika (c), neni 17 paragrafi (f) dhe nenit 40, paragrafi 40.2 shkronja a), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje lokale (GZRK Nr. 28/2008), nenit 15 paragrafi 7 dhe nenit 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenit 13, shkronja e), f) dhe p) si dhe nenit 46, paragrafi 46.2 shkronja a), të Statutit të Komunës së Vitisë, 01., Nr. 005/2008, të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën, 30.12.2019, miratoi këtë:

PROPOZIM RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 1

Qëllimet dhe fushëveprimi

- 1.1. Kjo rregullore ka për qëllim të vendosë një sistem të qëndrueshëm të menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe të ndihmojë në ruajtjen e mjedisit. Menaxhimi i integruar përfshin përpjekjet për t'i parandaluar dhe zvogëluar mbeturinat e deponuara.
- 1.2. Kjo rregullore përcakton:
 - (1) kushtet dhe mënyrën e menaxhimit të mbeturinave;
 - (2) të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve; dhe
 - (3) tarifat për shërbimin.
- 1.3. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
 - (1) mbeturinat e rrezikshme; dhe
 - (2) llumin, baltën dhe mbeturinat e ngjashme.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1. **Mbeturinë** domethënë substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.
- 2.2. **Gjenerues** domethënë prodhuesi ose personi që zotëron mbeturinën. Prodhues është çdo person që me veprimtarinë e vet gjeneron mbeturinë ose ia ndryshon natyrën ose përbërjen mbeturinës.
- 2.3. **Menaxhim i mbeturinave** domethënë menaxhim i integruar i mbeturinave. Menaxhim i integruar janë veprimtaritë për të menaxhuar mbeturinat dhe për të parandaluar dhe zvogëluar prodhimin dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Veprimtaritë përfshijnë ndarjen sipas llojit, ripërdorimin, kompostimin, shkarkimin, grumbullimin, mbledhjen, bartjen, ruajtjen, trajtimin, përpunimin, riciklimin, rikuperimin, deponimin përfundimtar të mbeturinave, si dhe vëzhgimin dhe kujdesin e vazhdueshëm pas deponimit.
- 2.4. **Operator** domethënë person i licencuar nga MMPH-ja për të ofruar shërbime të menaxhimit të mbeturinave.

- 2.4. **Operator** domethënë person i licencuar nga MMPH-ja për të ofruar shërbime të menaxhimit të mbeturinave.
- 2.5. **Mbledhje** domethënë mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 2.6. **Pikë grumbulluese** domethënë lokacion ku vendosen shportat, kontejnerët dhe qeset e thasët për grumbullimin e mbeturinave.
- 2.7. **Qendër grumbulluese** domethënë lokacion për pranimin ose grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve që i përcakton qendra.
- 2.8. **Shërbim** domethënë çdo shërbim në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Shërbimi përfshin mbledhjen, grumbullimin, bartjen dhe trajtimin e mbeturinave.
- 2.9. **Kompostim** domethënë trajtim i mbeturinave bio nën veprimin e mikroorganizmave në praninë e oksigjenit, me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara.
- 2.10. **Ligji për mbeturina** domethënë Ligji nr. 04/L-060, për mbeturina, GZRK 17/2012.
- 2.11. **MMPH** domethënë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- 2.12. **GZRK** domethënë Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Llojet dhe klasifikimi i mbeturinave

- 3.1. Lloji dhe klasifikimi i mbeturinave përcaktohet sipas:
- (1) Ligjit për mbeturina, nenet 6 dhe 7;
 - (2) Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 13/2013, për katalogun shtetëror të mbeturinave, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014; dhe
 - (3) akteve të tjera nënligjore.
- 3.2. **Mbeturina komunale** janë mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga veprimtaritë e tjera që për nga natyra dhe përbërja janë të ngjashme me mbeturinat nga amvisëritë.
- 3.3. **Mbeturina komerciale** janë mbeturinat që vijnë nga objektet që përdoret për qëllime të biznesit, sportit, edukimit ose rekreacionit, por nuk përfshijnë mbeturinat industriale.
- 3.4. **Mbeturinat industriale** janë mbeturinat nga ecuritë industriale, prodhimtaritë artizanale dhe veprimtaritë e tjera prodhuese. Prodhuesit janë përgjegjës për menaxhimin e tyre sipas Ligjit për mbeturina, neni 18, dhe akteve nënligjore.

- 3.5. **Mbeturina mjekësore** janë mbeturinat nga veprimtaria dhe produktet mjekësore dhe që mund të bartin sëmundje. Përfshijnë mbeturinat medicinale, humane dhe veterinare. Menaxhohen sipas:
- (1) Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 22/2013, për menaxhimin e mbeturinave medicinale, humane dhe veterinare, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014; dhe
 - (2) Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 10/2015, për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale, botuar në GZRK më 18 shtator 2015.
- 3.6. **Mbeturinat e rrezikshme** janë mbeturinat që kanë tiparet e përcaktuara me Ligjin për mbeturina, Shtojca III, Lista H. Mund të përfshijnë mbeturinat industriale dhe mjekësore.
- 3.7. **Mbeturina të parrezikshme** janë mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk kanë tipare të mbeturinave të rrezikshme.
- 3.8. **Mbeturina inerte** janë mbeturinat që nuk pësojnë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik ose biologjik aty ku deponohet. Nuk treten, nuk ndizen dhe nuk reagojnë fizikisht ose kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me lëndët e tjera, dhe nuk ndikojnë ndjeshëm në mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Kullimi, përmbajtja ndotëse dhe mbetjet ekotoksike të mbeturinave inerte janë të vlerës së papërfillshme dhe nuk rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore.
- 3.9. **Mbeturina të ndërtim-rrënimit** janë mbeturinat nga veprimtaria ndërtimore dhe nga meremetimi dhe rrënimi i objekteve. Menaxhohen sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 07/2015, për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, botuar në GZRK më 27 korrik 2015.
- 3.10. **Mbeturina të vëllimshme** janë mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë. Largohen, grumbullohen dhe barten në mënyrë të veçantë.
- 3.11. **Mbeturinat elektrike-elektronike** janë mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike. Menaxhohen sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 25/2014, për menaxhimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike, botuar në GZRK më 8 dhjetor 2014.
- 3.12. **Mbeturinat bio** janë mbeturina të biodegradueshme nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga amvisëritë, restorantet, hotelieritë, shitoret, si dhe mbeturinat e ngjashme nga industria ushqimore. Mund të trajtohen me kompostim. Nuk përfshijnë mbeturinat shtazore. Menaxhohet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 20/2014, për Menaxhimin e Mbeturinave Biodegraduese, të MMPH-së, botuar në GZRK më 6 nëntor 2014.
- 3.13. **Mbeturinat shtazore** janë mbeturinat dhe mbetjet e kafshëve që krijohen nga amvisëritë, mishtoret, thertoret dhe veprimtaritë e ngjashme.

Neni 4 Përgjegjësitë e Komunës

- 4.1. Komuna ka për detyrë të menaxhojë këto mbeturina:
- (1) mbeturinat komunale;
 - (2) mbeturinat komerciale;
 - (3) mbeturinat inerte;
 - (4) mbeturinat e vëllimshme;
 - (5) mbeturinat e ndërtim-rrënimit; dhe
 - (6) mbeturinat bio.
- 4.2. Komuna mbikëqyr zbatimin e Ligjit për mbeturina dhe akteve nënligjore në lidhje me:
- (1) mbeturinat industriale; dhe
 - (2) mbeturinat mjekësore.
- 4.3. Drejtoria përgjegjëse për shëndetësi vendos në vende publike të përshtatshme kontejnerë të barnave, ku qytetarët mund t'i hedhin barnat e skaduara ose të papërdorura.
- 4.4. Komuna menaxhon deponinë e mbeturinave inerte sipas:
- (1) Udhëzimit administrativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 08/2017, për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave, botuar në GZRK më 29 gusht 2017; dhe
 - (2) Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Nr. 07/2015, për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Demolimi i objekteve ndërtimore, botuar në GZRK më 27 korrik 2015.

Neni 5

Spektori i Menaxhimit të Mbeturinave

- 5.1. **Spektori** domethënë Spektori i Menaxhimit të Mbeturinave, i cili vepron në kuadër të drejtorisë përkatëse për Shërbimet Publike të Komunës.
- 5.2. Spektori ka për detyrë:
- (1) të hartojë dhe të zbatojë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me planin nacional;
 - (2) të caktojë vendndodhjen e pikave të grumbullimit;
 - (3) të përcaktojë llojin, numrin dhe vendosjen e shportave dhe kontejnerëve në përputhje me teknikën me të cilën mbledhen, ndahen dhe barten mbeturinat;
 - (4) të caktojë orarin e mbledhjes së mbeturinave në marrëveshje me operatorin, dhe sipas nevojës, ta autorizojë operatorin që të mbledhë mbeturinat edhe jashtë orarit të rregullt;
 - (5) të organizojë sistemin për mbledhjen dhe grumbullimin e veçantë dhe me pëlqimin e Kuvendit Komunal të caktojë vendndodhjen e qendrës grumbulluese për:
 - (a) mbeturinat e vëllimshme;
 - (b) mbeturinat e ndërtim-rrënimit; dhe
 - (c) mbeturinat elektrike-elektronike.
 - (6) të përcaktojë mirëmbajtjen e pikave dhe qendrave të grumbullimit si dhe shportave dhe kontejnerëve;

- (7) përmes operatorit t'u sigurojë gjeneruesve kontejnerët e kërkuar për mbeturina të ndërtim-rrënimit;
- (8) Të përcaktojnë kushtet dhe rregullat për menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike;
- (9) të identifikojë dhe të mënjanojë pikat ilegale të mbeturinave;
- (10) të vëzhgojë operatorët dhe t'ua sigurojë kushtet e veprimit;
- (11) të nxisë zvogëlimin e mbeturinave përmes konceptit 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim);
- (12) të njoftojë publikun për menaxhimin e mbeturinave;
- (13) të shqyrtojë ankesat e klientëve sa u përket shërbimeve;
- (14) të përpilojë raportet për menaxhimin e mbeturinave, përfshi raportin vjetor që i dorëzohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor brenda 31 marsit; dhe
- (15) të bartë përgjegjësi të tjera sipas kësaj rregulloreje.

Neni 6 Operatorët

- 6.1. Organi kontraktues i Komunës përzgjedh operatorët për të ofruar shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
- 6.1.1. Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës pa ndjekë procedurat e tenderimit sipas legjislacionit për prokurimin publik.
- 6.2. Operatorët duhet të veprojnë sipas kontratës dhe dispozitave ligjore.

Neni 7 Të drejtat dhe detyrimet e gjeneruesve të mbeturinave

- 7.1. Çdo gjenerues ka të drejtën e qasjes në shërbim. Ai ka të drejtë të parashtrojë ankesë lidhur me shërbimin.
- 7.2. Gjeneruesit kanë për detyrë:
 - (1) të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;
 - (2) t'i ndajnë mbeturinat sipas llojit;
 - (3) t'i hedhin ose dorëzojnë mbeturinat e një lloji:
 - a) në shporta dhe kontejnerë të përcaktuar për atë lloj;
 - b) në pika ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj; ose
 - c) te operatori;
 - (4) të respektojnë rregullat e shkarkimit, të përcaktuara sipas planin të menaxhimit;
 - (5) të përpiqen me zvogëluar sasinë e mbeturinave përmes kompostimit shtëpiak dhe formave të tjera të mundshme;
 - (6) ta njoftojnë Sektorin kur gjenerojnë mbeturina të ndërtim-rrënimit;
 - (7) të regjistrojnë amvisërinë dhe veprimtarinë e vet dhe të njoftojë ndryshimin e të dhënave lidhur me kontrollin, përfshi rastet e shitblerjes, trashëgimisë, qiradhënies ose bartjes në mënyrë tjetër; dhe
 - (8) të paguajnë tarifat e shërbimit.

- 7.3. Veprimtaritë prodhuese kanë për detyrë t'i dorëzojnë Komunës planin e menaxhimit të mbeturinave që gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 8

Regjistrimi i gjeneruesve

- 8.1. Sektori cakton mënyrën e regjistrimit të amvisërive dhe veprimtarive si gjenerues.
- 8.2. Amvisëritë dhe veprimtaritë i regjistrojnë:
- (1) Sektori; ose
 - (2) operatori sipas marrëveshjes me Komunën.
- 8.3. Amvisëritë dhe veprimtaritë regjistrohen sipas këtyre dokumenteve:
- (1) akti që dëshmon kontrollin mbi amvisërinë ose veprimtarinë, siç janë kontrata e shitblerjes, akti i dhurimit, certifikata e pronësisë, kontrata e qirasë, certifikata e biznesit e akte të tjera;
 - (2) regjistrimi i njehsorit të energjisë elektrike;
 - (3) dëftesa e pagesës për mbeturinat në vendbanimin ose lokalitetin paraprak, nëse ka pasur; dhe
 - (4) dokumenti i identifikimit.
- 8.4. Gjeneruesit ndahen në kategoritë dhe nënkategoritë e përcaktuara në **Shtojcën A**.
- 8.5. Nëse gjeneruesi nuk e regjistron amvisërinë ose veprimtarinë, Sektori ose operatori mund ta regjistrojë atë njëanshëm, duke njoftuar gjeneruesin, (në ato lokalitete ku kompania e ofron shërbimin).

Neni 9

Caktimi dhe arkëtimi i tarifave

- 9.1. Kuvendi Komunal cakton tarifat e shërbimeve. Merr parasysh ndikimin e tarifave në mjedisin jetësor dhe ndryshimet që rekomandojnë Sektori dhe operatorët.
- 9.2. Operatorët i arkëtojnë tarifat sipas marrëveshjes me Komunën.
- 9.3. Sektori e rishikon lartësinë e tarifave të paktën çdo tri vjet, duke llogaritur koston e shërbimeve, dhe i rekomandon drejtorisë përkatëse për shërbime publike, ndryshimet që i sheh të veshme.
- 9.4. Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike shqyrton ndryshimet që rekomandon Sektori. Pas shqyrtimit, ia paraqet për miratim Kuvendit Komunal dhe ia përcjell për dijeni Kryetarit të Komunës dhe operatorëve.
- 9.5. Sektori boton një shpjegim rreth caktimit të tarifave, që përfshin llogaritjen e koston dhe arsyet për lartësinë e caktuar.

Neni 10

Lartësia dhe arkëtimi i tarifave

- 10.1. Gjeneruesit paguajnë tarifën e shërbimit sipas kategorisë dhe nënkategorisë në lartësinë e cekur në **Shtojcën B**.
- 10.2. Tarifat faturohen çdo muaj. Faturat u dorëzohen gjeneruesve brenda 10 ditëve pas faturimit.
- 10.3. Kuvendi Komunal do ta përcaktojë tarifën për mbeturinat e ndërtim-rrënimit me akt të posaçëm.
- 10.4. Sektori mund të ofrojë falas mbledhjen e periodeke të mbeturinave të vëllimshme.

Neni 11

Para paguesit dhe jo banorët

- 11.1. Gjeneruesit jo banorë janë gjenerues të kategorisë A, që nuk janë banorë të përhershëm të Komunës. Ata paguajnë tarifën njëherë në vit, por duhet të dëshmojnë se nuk janë banorë të përhershëm. Dëshmitë përfshijnë:
- (1) faturën e energjisë elektrike që tregon se nuk konsumojnë rrymë në pjesën më të madhe të vitit; dhe
 - (2) dokumentet e tjera që i përcakton Sektori.

Neni 12

Kufizimet

- 12.1. Ndalohet:
- (1) të hidhen mbeturina në hapësira jashtë shportave, kontejnerëve, pikave ose qendrave grumbulluese ose lokacioneve të përcaktuara për grumbullim ose deponim;
 - (2) të hidhen mbeturinave të përziera ose të llojit tjetër në shporta ose kontejnerë të përcaktuar për mbeturina të një lloji;
 - (3) të hidhen ose të digjen mbeturina në rrugë, hapësira publike, hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve kolektive ose në pronë private;
 - (4) të hidhen në kontejnerë publikë mbeturina të çfarëdo lloji pos mbeturinave komunale dhe komerciale;
 - (5) të hidhen mbeturina në sipërfaqe ujore, përfshi lumenjtë, liqenet, rrjedhat ujore, përrenjtë dhe sipërfaqet e tjera, ose pranë tyre;
 - (6) të zhvendosen shportat, kontejnerët ose pikat grumbulluese pa autorizimin e Komunës;
 - (7) të digjen mbeturina në pika grumbulluese;
 - (8) të nxirren, të shpërndahen ose përdoren si ushqim për kafshët mbeturinat nga pikat grumbulluese; dhe
 - (9) të derdhen ose të rrjedhin mbeturina gjatë bartjes së tyre.
- 12.2. Kushdo që bart mbeturina duhet të marrë masa për të penguar derdhjen ose rrjedhjen e mbeturinave.
- 12.3. Askush nuk mund ta ndryshojë mënyrën, metodat, teknikën ose teknologjinë e largimit të mbeturinave që përcaktohet me kontratë ose vendim të autoriteteve komunale.

Neni 13

Gjobat dhe ndëshkimet

- 13.1. Organet kompetente mund të gjobitin shkelësit sipas Udhëzimit Administrativ për Gjopa Mandatore Nr. 06/2018, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, botuar në GZRK më 7 nëntor 2018, neni 16. (aneks B).
- 13.2. Inspektori i Komunës mund të bëjë kallëzim penal për shkelje të Ligjit për mbeturina që përbëjnë vepër penale. Kallëzimin e bënë përmes kryetarit të Komunës.
- 13.3. Zyrtari përgjegjës për inspektim duhet të shqiptojë gjobë për shkelje lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
- 13.4. Kushdo që nuk njofton Sektorin kur gjeneron mbeturina të ndërtim-rrënimit gjobitet me gjobë nga 200 deri në 500 euro.
- 13.5. Kushdo që grumbullon plehun e kafshëve, sillazhat apo lloje tjera të mbetjeve që kundërmojnë erë në hapësirat publike dhe ato private brenda vendbanimit dhe në distancë 300 m nga shtëpia e fundit e banimit apo ndonje veprimtarie tjetër, gjobitet me gjobë nga 100 – 300 euro.
- 13.6. Kushdo që kryen veprimet e ndaluara sipas Nenit 12 gjobitet deri në 100 euro, përveç nëse përcaktohet ndryshe me:
- (1) Ligjin Nr. 05/L-087, për kundërvajtje, GZRK 33/2016;
 - (2) Ligjin për mbeturina, Nenet 71–75;
 - (3) Udhëzimin administrativ i MMPH-së, nr. 06/2018, për ndëshkime me gjoba mandatore, botuar në GZRK më 7 nëntor 2018, neni 16, dhe përfshi në këtë rregullore si Shtojca B; ose
 - (4) ndonjë tjetër ligj ose akt nënligjor të MMPH-së.

Neni 14

Mbikëqyrja

- 14.1. Vëzhgojnë zbatimin e kësaj rregulloreje:
- (1) Drejtoria përkatëse për Shërbime Publike.
- 14.2. Inspektojnë zbatimin e Ligjit për mbeturina dhe të kësaj rregulloreje:
- (2) inspektori mjedisor i Komunës;
 - (3) zyrtarët tjerë të autorizuar të Komunës; dhe
 - (4) Policia e Kosovës.
- 14.3. Inspektimi bëhet sipas Ligjit për mbeturina, nenet 61–69.

Neni 15

Shtojcat

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore janë edhe:

- (1) Shtojca A-Kategoritë e gjeneruesve;
- (2) Shtojca B-Tarifat, dhe
- (3) Shtojca C-Gjobat Mandatore.

Neni 16
Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Në rast se dispozitat e kësaj rregulloreje bien ndesh me ligjin për mbeturina, epërsi do të kenë Dispozitat ligjore.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit të aktit në ueb faqen e Komunës së Vitisë.

Drejtori :

/Nexhmedin Jakupi /

Viti, me dt.13.07.2020

Kryetari i Komunës:

/ Sokol Haliti /



SHTOJCA A
Kategoritë e gjeneruesve

Kategoria	Nënkategoria	Shembuj
A — amvisëritë	A-1 — klientët e shërbyer derë më derë	—
	A-2 — klientët e shërbyer me kontejnerë të përbashkët	—
	A-3 — klientët jo banorë të përhershëm	—
K — klientët komercialë dhe industrialë	K-1 — veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese	Qoshqet dhe shitoret e madhësisë së ngjashme me të qoshqeve, shitoret e dyqanet e vogla, siç janë shitësit e kafes, disqeve, kozmetikës, thjerrëzave dhe suvenirëve, argjendaritë, orëtarët, agjencitë turistike, auto-shkollat, rrobaqepësit, këpucëtarët, fotografët, butikët, libraritë, dyqanet e pastrimit kimik, gurgdhendësit, këmbimoret, llamarinë-punuesit dhe axhustatorët, zyrat e shërbimeve profesionale siç janë zyrat e vogla të avokatëve, noterëve, përmbaruesve, këshilltarëve financiarë dhe organizatave jo qeveritare, veprimtari të tjera të vogla siç janë parkingjet, qendrat e video-lojërave, zyrë për përkthime të gjuhëve të huaja, zyrat e inkasimit, shtypshkronja, vullkanizer, veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
	K-2 — subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të ulët të shërbimit	lokalet për shitjen dhe mirëmbajtjen e automjeteve (duke përjashtuar auto-ngjyrosësit), frizerët dhe lokalet tjera të kujdesit personal (m. f.), barnatoret, klinikat e vogla dhe ambulancat stomatologjike deri në dy karrige, serviset e pajisjeve teknike dhe elektronike, shitoret e vogla përfshirë shitoret sanitare, të mobilieve, auto-pjesëve, tekstilit dhe këpucëve, hekurishte, mishtoret, shitore të ndryshme, autolarje, byrektoret, gjellëtoret, ëmbëltoreset, bastoret, zyrat postare e të ngjashme, objekte fetare të vogla, veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë).

	K-3 — subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale e industriale me kosto të moderuar të shërbimit	furrat e bukës, byrektoret, kafiteritë, lokale të vogla të ushqimit të shpejtë, shitoret ushqimore dhe podrumet e pijeve, bankat, sallonet e sanitarisë, sallonët e mëdha të mobileve, qendra sportive dhe të fitnesit, veprimtaritë zejtare më të rënda, si autongjyrosësit dhe xhamaprerësit, poliklinikat, ambulancat specialistike dhe ambulancat stomatologjike me mbi dy karrige, bujtinat, pompat e benzinës, restorantet e vogla, veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë).
	K-4 — subjektet e mesme dhe të mëdha komercial e industriale me kosto të lartë të shërbimit	Shitoret e mëdha, restorantet përfshi gjellëtoret, qebaptoret, dhe lokalet e ushqimit të shpejtë, klubet e natës, veprimtarit hoteliere, pompat e benzinës me restorante, depo e materialeve ushqimore, supermarketet, veprimtari të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
	K5 — subjektet komerciale e industriale të shërbyera me kontratë të veçantë	—
I — klientët institucionale — me kontratë të veçantë	I-1 — institucionet komunale	institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme
		qendrat kryesore të mjekësisë familjare
		bashkësitë lokale, zyrat e vendit, objektet e Komunës
		teatrot e kinematë komunale, objektet kulturore e sportive
	I-2 — institucionet qendrore dhe ndërkombëtare	zjarrfikësit dhe bashkësitë fetare
		institucionet e nivelit terciar të kujdesit shëndetësor
		policia
		ndërmarrjet publike
		posta
		gjykatat
		prokurorinë
		agjencitë e pavarura
		qendrat për punë sociale
		zyrat e tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës
		përfaqësitë diplomatike e konsullore
		përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare

Vërejtje: Gjeneruesit e nënkategorive **K-5**, **I-1** dhe **I-2** shërbejnë me kontejnerë 1,1 m³. Gjeneruesit duhet të kenë hapësirë brenda hapësirave të tyre për të vendosë kontejnerët.

SHTOJCA B
Tarifat

Kategoria e gjeneruesit ose lloji i mbeturinës	Tarifa (EUR) me TVSH	
	për muaj	për zbrazje të kontejnerit 1,1 m ³
A-1	5.00	
A-2	5.00	
A-3 (tarifa vjetore)	20.00	
K-1	7.00	
K-2	11.70	
K-3	20.70	
K-4	27.80	
K-5	-	12.10
I-1	-	12.10
I-2	-	12.10

SHTOJCA C

Gjobat mandatore

(Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nr. 06/2018, për ndëshkime me gjoba mandatore, botuar në GZRK më 7 nëntor 2018, neni 16).

1. Veprimet ndëshkuese me gjobë mandatorë dhe vlera e gjobës për personin:

1.1. Me gjobë në vlerë prej 20 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.1.1. hedhë cigare në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.1.2. hedhja e çamçakëzit në rrugë ose në sipërfaqe publike.

1.2. Me gjobë në vlerë prej 30 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.2.1. hedhë ambalazh dhe mbeturina letre në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.2. hedhë ambalazh dhe mbeturina plastike në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.3. hedhë ambalazh dhe mbeturina qelqi në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.4. hedhë kanoçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.5. hedhë mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.6. si kalimtar rasti hedhë çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike.

1.3. Me gjobë në vlerë prej 40 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.3.1. hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale;
- 1.3.2. hulumton nëpër kontejner të mbeturinave, merr ose shkapërderdh-hedhë mbeturina prej kontejnerit jashtë;
- 1.3.3. hedhë mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat si: organike, qelqi, letra, plastika, metali, etj.;
- 1.3.4. mbeturinat nga copëtimi i drunjve i lenë në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.3.5. mbeturinat nga thëngjilli i len në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.3.6. nuk e pastron jashtëqitjen e kafshës së tyre në rrugë, trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv dhe objekte tjera publike.

1.4. Me gjobë në vlerë prej 50 Euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 1.4.1. hedhë cigare në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.2. hedhë ambalazh dhe mbeturina letre në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.3. hedhë ambalazh dhe mbeturina plastike në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.4. hedhë ambalazh dhe mbeturinë qelqi në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.5. hedhë kanaçe në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.6. hedhë mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.7. dëmton kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.8. i ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
- 1.4.9. hedhë akumulatore në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.10. hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.11. hedhë mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërfaqe publike;
- 1.4.12. hedhë ambalazh dhe mbeturina letre në natyrë;
- 1.4.13. hedhë ambalazh dhe mbeturina Plastike në natyrë;
- 1.4.14. hedhë ambalazh dhe mbeturina qelqi në natyrë;

- 1.7.7. djegë goma, mbeturina tjera prej gome, në hapësirave private, publike, rrugë ose në natyrë;
- 1.7.8. djegë mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.9. djegë mbeturina të ndryshme prej letre në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.10. djegë vajra, mbeturina të vajrave në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.11. derdh çfarëdo materiali në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë me ç'rast prej saj krijohen mbeturina.